

Gjykata Themelore Gjilan – Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Burim Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.TH. nga Kamenica, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal” Uniqa Group Austria me seli në Prishtinë, Rr. “Pashko Vasa” pa nr. të cilën me autorizim e përfaqëson A.N. nga ..., për shkak të kompensimit të dëmit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor me datë 07.09.2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Pjesërisht aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit K.TH. nga ... dhe **Detyrohet e paditura** Kompania e Sigurimeve “Sigal” Uniqa Group Austria me seli në Prishtinë, **që në emër të kompensimit të dëmit material** për dëmtimin – riparimin e veturës të markës “Golf” dëm i shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 31.07.2011 në ..., ti paguaj shumë prej 1.050 Euro (njëmijë e pesëdhjetë euro), me kamat ashtu siç paguajnë bankat kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara pa destinim të veçantë mbi një vit si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 255 Euro (dyqind e pesëdhjetë e pesë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit K.TH. me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Sigal” Uniqa Group Austria me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material për dëmtimin e veturës “Golf” të paguaj edhe shumën prej 384 Euro (treqind e tetëdhjetë e katër euro), **refuzohet si e pa bazuar.**

III. Detyrohen paditësi K.TH. që në emër të taksës për padi kësaj gjykate ti paguaj shumën prej 20 Euro (njëzet euro), **dhe e paditura** Kompania e Sigurimeve “Sigal” Uniqa Group Austria me seli në Prishtinë për vendim kësaj gjykate ti paguaj shumën prej 10 Euro (dhjetë euro), krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësi K.TH. nga ..., përmes të autorizuarit të tij H.M., avokat nga Gjilani, në këtë gjykatë më datë 20.05.2013 ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Sigal” Uniqa Group Austria me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit materialit.

E paditura KS. “Sigal” Uniqa Group Austria Sh.A. përmes të autorizuarit të saj A.N., nuk e ka kontestuar bazën juridike të padisë dhe kërkesëpadisë në kuptim të përgjegjësisë për shkaktimin e aksidentit, por e kanë kontestuar lartësinë e kërkesëpadisë.

Paditësi në seancën për shqyrtim kryesor ka theksuar se aksidenti i komunikacionit nuk është shkaktuar në ... më datë 14.06.2010 siç e ka theksuar avokati por është shkaktuar me datë 31.07.2011 në..., ndërkaq aksidenti në ...ka qenë raste tjetër i aksidentit për të cilin jam kompensuar, pra përfaqësuesi im avokati H.M. që tani është Noter, gabimisht e ka shkruar në padi se aksidenti është shkaktuar në ...

ndërkaq ai është shkaktuar në, më tutje ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe ka theksuar se unë e kam rregulluar veturën dhe për këtë i kam edhe faturat, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia të aprovohet si e bazuar, dhe të merret prova përmes një ekspertize të makinerisë.

I autorizuari i të paditurës, A.N. në seancën për shqyrtim kryesor ka theksuar se nuk është kontestuese baza juridike e padisë por kontestuese mbetet lartësia e saj, nuk e ka kontestuar faktin se të merret prova me ekspertizë të makinerisë.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata në këtë çështje juridike ka lexuar provat materiale si: faturën e dt.17.08.2011, kuponin nr.003528 prej dt.19.09.2011, kuponin nr.0429882 prej dt.10.08.2011, procesverbalin mbi evidentimin e dëmit nr.0964/11 prej dt.31.07.2011 dhe ekspertizën e punuar nga ekspertit i makinerisë S.Z. të dt.15.04.2016 dhe pas administrimit të këtyre provave një nga një e të tërave bashkërisht, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata e ka vërtetuar gjendjen faktike prej nga ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata në rastin konkret vëren se ndërmjet palëve ndërgjyqësore nuk është kontestuese baza juridike e padisë dhe as përgjegjësia për shkaktimin e dëmit dhe kompensimin e tij (kjo nuk është kontestuar nga e paditura), por kontestuese në rastin konkret është lartësia e kërkesëpadisë rrjedhimisht lartësia e dëmit për riparimin e veturës.

Meqenëse baza juridike e kërkesëpadisë nuk ka qenë kontestuese gjykata ka administruar provat ta vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë ndërkaq shkaktarin e aksidentit dhe përgjegjësini për kompensimin e dëmit e ka marrë si fakt të vërtetuar ngase ai nuk është kontestuar nga e paditura.

Sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë gjykata ka vendosur duke u mbështetur në ekspertizën e ekspertit të makinerisë të S.Z. në të cilën ekspertizë paditësi nuk ka pasur vërejtje dhe nuk ka kërkuar që eksperti të dëgjohet drejtpërdrejtë në seancë, këtë nuk e ka kërkuar as e paditura edhe pse me kohë e ka pranuar ekspertizën (25.05.2016), prandaj gjykata e ka marrë për bazë vlerësimin e ekspertit për përcaktimin e lartësisë së kërkesëpadisë.

Eksperti i makinerisë sipas vendimit të gjykatës e ka bërë vlerësimin dhe llogaritjen e dëmit për veturën VW “Golf IV” dhe ka llogaritur dëmin për pjesët e dëmtuara përkatësisht riparimin e tyre dhe për pjesët e dëmtuara lartësia e dëmit është vlerësuar në shumë prej 750 Euro dhe ngjyrosja e pjesëve të dëmtuara është llogaritur në shumë prej 300 Euro dhe i tërë dëmi është llogaritur në shumë prej 1.050 Euro.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë në shumë prej 384 Euro, gjykata ka vendosur duke u mbështetur në ekspertizën e ekspertit të makinerisë ngase me këtë ekspertizë është vlerësuar në tërësi dëmi dhe lartësia e tij, dhe gjykata nuk ka mundur ta marrë për bazë lartësinë që e ka prezantuar paditësi në faturën pa nr. prej dt.17.08.2011 lëshuar nga D.P.Z. “Dati” në për ngjyrosjen të pjesëve të dëmtuara në shumë prej 340 Euro, dhe kuponin nr.003528 prej dt.19.09.2011 lëshuar prej Ndërmarrjes Tregtare Shërbyese “OLLURI” nga Bibaj - Ferizaj por edhe kuponit 0429882 prej dt.10.08.2011 në shumë prej 864 Euro, nga fakti se sipas ekspertit të makinerisë S.Z. sipas çmimeve të tregut pjesët e dëmtuara kanë kushtuar në shumë prej 750 Euro sipas pjesëve të dëmtuara të automjetit dhe ngjyrosja e tyre ka kushtuar

në shumë prej 300 Euro dhe gjykata është bazuar në vlerësimin e ekspertit të pavarur dhe kompetentë – inxhinier i makinerisë dhe jo në faturat që i ka prezantuar paditësi.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur duke u mbështetur në nenin 252 pag.1 të LPK-së si dhe në bazë të TA-së të OAK-së, ku ia pranojë shpenzimet paditësit për përpilimin e padisë nga avokati H.M. si dhe për shpenzimet e shpërblimit të ekspertit të makinerisë në shumë prej 120 Euro, ndërkaq e ka detyruar paditësin që ta paguaj taksën për padi, ngase sipas shkresave të lëndës taksa e tillë nuk është paguar në shumë prej 20 Euro, si dhe të paditurën ta paguaj taksën për vendim në shumë prej 10 Euro, krejt këto sipas udhëzimit administrativ për unifikimin e taksave gjyqësore të KGJK-së.

Gjykata nga të cekurat më lartë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NË KAMENICË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.82/2013, më datë 07.09.2016

Gj y q t a r i,
Burim Shala,d.v.

KËSHILLA JURIDIKE - Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.